



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

EKSTRAKT

Nga procesverbali i mbledhjes së 4-të të Komitetit për Komunitete të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 07.05.2026, në sallën nr. 2 në katin e tretë me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Alush Bikliqi, kryesues
2. Fitim Shala, anëtar
3. Gentianë Hoxhaj , anëtare
4. Hyra Bytyqi, anëtare
5. Shahadije Bikliqi Dragaçina, anëtare
6. Yllëza Bedrolli, anëtare
7. Slavisa Trajkovic, anëtar
8. Maksut Gashi, anëtar,
9. Zoran Cirkovic, anëtar
10. Ollga Guciq, anëtare
- 11.Fehmi Rexhepi, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Ardian Olluri DI
2. Zoran Stanojevic ZLK
3. Naser Bytyqi, përkthyes shqip-serbisht

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**,

Kryesuesi i Komitetit Alush Bikliqi, pasi i përshëndeti të pranishmit, tha se ftesën me material e keni marr me kohë të cilin e lexoi në vazhdim:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja 3-të e Komitetit për Komunitete
2. Informatë e shkurtër nga Drejtorati për Infrastrukturë rreth punimeve që po zhvillohen në teren.
3. Raporti mujor i punës së Zyrës Komunale për Komunitete (ZKK-së)
4. Të ndryshme

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin.

Meqë askush nuk u lajmërua për fjalë, kryesuesi vuri në votim rendin e ditës së propozuar dhe pas votimit konstatoi se Komiteti për punën e kësaj mbledhje unanimitisht aprovoi këtë:

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë.

I

Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e 3-të e Komitetit për Komunitete

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Alush Bikliqi tha se a ka vërejte rreth ekstraktit të procesverbalit nga mbledhjet e kaluara.

Meqë askush nuk u lajmërua për fjalë, kryesuesi vuri në votim ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja 3-të e Komitetit për Komunitete dhe pas votimit konstatoi se Komiteti unanimitisht aprovoi.

II

Informatë e shkurtër nga Drejtorati për Infrastrukturë rreth punimeve që po zhvillohen ne teren.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Alush Bikliqi ia kaloi fjalën Ardian Ollurit drejtor i DI, e cili i njoftoi në pika të shkurta rreth projekteve qe po zhvillohen ne teren.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin.

Alush Bikliqi Kryesues i Komitetet tha se kur pritet të përfundojnë punimet në QKMF dhe kur pritet të lëshohet.

Ardian Olluri, tha se shumë shpejt pasi që mbi 90% e punëve janë përfunduar dhe po shkon në bazë të planit dinamik.

Fehmi Rexhepi, tha pse në fshatin Medvec nuk ka asnjë projekt pasi që më herët është thënë që do të jetë asfaltimi i disa rrugicave dhe zgjerimi dhe asfaltimi i rrugës afër shkollës.

Zoran Cirkovic, tha se me sa po shihet dhe këtë buxhet nuk do të ketë asgjë për fshatin Grackë ku për një rrugë po thuhet që 12 vite e diskutojmë dhe shtyhet çdo vit pse po ndodh kjo edhe pse në këtë rrugë jetojnë komuniteti jo shumë . Po ashtu edhe ndriçimi publik mungon në një pjesë ku janë 6 shtylla po nuk kanë poqa elektrik fare.

Ardian Olluri, tha se kanë qenë në projekt e planifikuar edhe rruga për Medvec edhe në Grackë por thesari na ka bllokuar mjetet dhe është dashtë këtë mbledhje në kuvend me i hiq ato projekte për shkak të përmbaruesit.

Hyra Bytyçi, tha se a keni aplikuar me ndonjë organizatë për ndonjë projekt për komunitetet se më herët ka pas aplikime të tilla.

Shahadije Bikliqi, tha pse janë anuluar këto projekte në disa fshatra që theksuat.

Alush Bikliqi, tha se në Janjevë ka pas nevojë për investime sidomos në pjesën ku banojnë komuniteti kroat pasi që aty ka nevojë për ndriçim dhe pjese tjera.

Ardian Olluri, tha se jo këtë vit ende nuk kemi aplikuar me ndonjë organizatë. Ju tregova janë anuluar ato projekte për shkak të përmbaruesit që na ka bllokuar mjetet. Në Janjevë janë bërë disa investime dhe pritjet edhe tjera të ketë. Ndërsa sa i përket atyre shtyllave ajo është kompetencë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Meqë diskutime të tjera nuk pati u kalua në pikën në vazhdim.

III

Raporti mujor i punës së Zyrës Komunale për Komunitete (ZKK-së)

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Alush Bikliqi ia kaloi fjalën Zoran Stanojevic, nga ZKKK e cila i njoftoi në pika të shkurta.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin.

Hyra Bytyçi, tha ju si zyre a keni bashkëpunim me Kryqin e Kuq.

Zoran Stanojevic, tha se nuk kemi ndonjë bashkëpunim por ua sugjerojmë familjeve që të shkojnë të kryqi i kuq për ndonjë ndihmë.

Fitim Shala, tha se i përmendet disa familje të riatdhësuar pse ato s'kanë përfituar?

Zoran Stanojevic, është një rregullore e ministrisë ku duhet të plotësohen disa kriterë që të jenë përfitues i banimit 6+6 muaj. Dhe disa nga këto familje nuk kanë plotësuar ato kriterë.

Fehmi Rexhepi, tha se në Medvec është një familje vetëm një anëtar dhe nuk ka shtëpi nuk po i ndihmon askush.

Zoran Stanojevic, tha se nuk kemi mundësi me i ndihmuar sepse s'kemi mejte më shumë.

Zoran Cirkovic, tha se dua ta bëjë një falënderim për QPS-në dhe ZKK-në, të cilët pas diskutimit në komitet për rastin e gruas në Grackë, menjëherë kanë dale në teren ja kanë ofruar ndihmë por ajo nuk ka pranuar ndihmën por unë jam shumë falënderues në emër të komitetit. Gjithashtu kam një falënderim edhe për zyrën e kryetarit shërbimet publike dhe akteret tjera që çdo herë po e bëjnë pastrimin e varrezave me kohë.

Alush Bikliqi, tha se edhe unë i falënderoj ekipin e QPS-së, për një punë të mirë që kanë bërë për të cilën me kanë njoftuare dhe mua.

Meqë diskutime të tjera nuk pati u kalua në pikën në vazhdim?

IV Të ndryshme

Meqë çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 11'³⁰.

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu
Zyrtar Ligjor

Kryesuesi i Komitetit

Alush Bikliqi